



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seanca e VII (shtatë) e Kuvendit të Komunës mbajtur, më 16. VII. 2012 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2013-2015 e Komunës së Gjiçanit,
3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15.min

Kryesuesi i seancës
z. Izmi Zeka

Në punimet e seancës së shtatë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit
Kryetari i Komunës
Drejtoret e drejtorive
Përfaqësuesi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
Përfaqësuesi i OSB-së
Përfaqësuesi i Forumit Demokratik "Anamorava"
Mediet

Seancën e shtatë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e seancës së shtatë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së shtatë janë prezent 40 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi 1 (Tefik Maksuti).

Në vazhdim të punimeve, kryesuesi theksoi se rendin e punës e keni marrë dhe për këtë seancë e kemi një pikë e cila është: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2013-2015 e Komunës së Gjilanit, prandaj nëse ka ndonjë vërejtje lidhur me rendin e punës mund të deklaroheni?

Arben Mehmeti- unë po iu përkujtoj se ne si grup parlamentar i LDK-së në seancën e kaluar kemi kërkuar që nga kjo seancë të bëhet transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës, por duke pasur parasysh se ka qenë procedurë e shkurtër për të filluar procedurat me qëllim të realizimit të kësaj kërkesë, ne kemi vazhduar që të jemi grup parlamentar konstruktiv dhe të shërbejmë në interes të qytetarëve të Gjilanit, por kjo nuk do të thotë se i kemi përjashtuar të gjitha metodat dhe veprimet të cilat ndoshta mund edhe të mos jenë në interes të këtij pushteti. Është një nismë e jona për ta realizuar këtë kërkesë e cila është legjitime me faktin se KK ka marrë edhe çmim për transparencë. Nëse nuk realizohet kjo kërkesë do të jetë shumë joserioze dhe kjo do të vlejë edhe për ato mekanizma të cilat i kanë dhënë këto çmime. Kjo është kërkesë e ligjshme dhe në interes të qytetarëve të Gjilanit dhe qytetarët duhet ta dinë se anëtarët e Kuvendit në çfarë aspekti po merren me interesat e tyre?

Mirëpo seancat e Kuvendit të Komunës mund të vendosen edhe në ueb faqe të Komunës e të cilat në këtë formë mund të përcillen nga qytetarët e interesuar në çfarëdo kohe që dëshirojnë. Është mirë që kjo kërkesë të realizohet sa më parë që është e mundshme.

Sa i përket rendit të ditës kemi disa vërejtjet në pikën e tretë të rendit të punës, por përveç kësaj kemi edhe diçka për të shtuar nën pikën të ndryshme.

Nevzad Rushiti- unë e kam një vërejtje serioze te pika e tretë e rendit të punës aty ku është një propozim - vendim për zgjidhjen urbanistike të “Dheu Bardhë”. Unë e kam vërejt se çka kërkohet dhe si është marrë një vendim për këtë rast. Së pari kjo pikë e rendit të punës nuk ka kaluar në Komitetin për Pronë

Izmi Zeka- për këtë pikë do të debatohet pasi të aprovohet rendi i punës dhe do të shikojmë se a i ka kaluar të gjitha procedurat?

Bahrie Veseli- i nderuari kryesues ju vazhdimisht keni kërkuar që ne kërkesat tona t’i bëjmë me shkrim, por unë e kam dorëzuar një kërkesë për të cilën që plotë tre muaj nuk kam marrë përgjigje! Unë e kam dorëzuar një kërkesë me nënshkrime të qytetarëve të lagjes dhe të cilat janë edhe të protokolluara nga Shërbimi i Kuvendit, prandaj kërkoj përgjigje për këto kërkesa që i kam dorëzuar?

Izmi Zeka- sa i përket kërkesës së LDK-së për transmetim të seancave, kjo kërkesë do të realizohet prej shtatorit dhe prej këtij muaji të gjitha seancat do të transmetohen. Ne do të merremi vesh me TV “VALIN” dhe nëse kanë mundësi për ta bërë transmetimin e drejtpërdrejtë, nëse nuk mund në këtë formë do të gjenden variante të tjera. Do të bëhet incizimi dhe ai incizim do të transmetohet në një kohë të përshtatshme për t’ia mundësuar qytetarëve për të parë se çka është biseduar në seanca.

Sa i përket kërkesës së zonjës Bahrie, po e përsëris edhe njëherë se drejtorët e kanë obligim ligjor për të kthyer përgjigje, por nëse nuk kanë dhënë përgjigje në shtator t’i përmbledh

të gjitha pyetjet që i ka bërë opozita, kurse ne do të përgjigjemi në të gjitha pyetjet. Është obligim ligjor për t'iu kthyer përgjigje.

Sa i përket pikës së tretë për propozim zgjidhje urbanistike e cila nuk ka kaluar në Komitet të Pronës, duhet ta dini se propozim zgjidhjen urbanistike e bën DUMM.

Mirëpo duhet kuptuar se kjo është çështje emergjente.

Sokol Haziri- edhe unë kam dilemë se a do të hyjë në rend të punës edhe pika e tretë apo do të bëjmë ndryshime? Ne në takimin e fundit të KPF-së e kemi pasur për diskutim vetëm një pikë të rendit të punës vetëm Kornizën afatmesme buxhetore, por në ndërkohë është krijuar një praktikë sidomos nga Drejtoria për Urbanizëm, që të propozojnë vazhdimisht diçka urgjente dhe nuk do të duhej ishte një praktikë e tillë, sepse asgjë në seancë nuk duhet të vijë e jashtëzakonshme. Nuk duhet të bëhet e jashtëzakonshmja rregull, prandaj do të ishte mirë që edhe në kuptim të respektimit edhe të afatit dhe ligjit që këso gjëra mos të ndodhin në të ardhmen. Sidoqoftë është një çështje humane të cilën e kuptojmë kësaj radhe, por herëve të tjera kërkojmë që materiale të tilla mos të na hidhen në tavolina për pa e ditur se çka po ndodh, sepse në këtë rast është vetëm mos azhureteti i Drejtorisë së Urbanizmit dhe nuk ka asgjë tjetër.

Arben Mehmeti- një vërejtje e kemi te Zyra për Marrëdhënie Publikun, sepse unë e kam dërguar një shkresë zyrtare në Zyrën e Personelit për ta marrë një dokument (listën e stafit të Komunës). Mirëpo Zyra e Personelit më ka njoftuar se këtë e ka kërkuar Zyra për Marrëdhënie me Publikun e të cilët duhet t' i bëjnë analizat si ndonjë laborator, kurse mandej ata të konstatojnë se duhet të na japin përgjigje apo jo?

Ne jemi marrë vesh si Kuvend që përgjigje të kërkojmë prej drejtorive, kryetarit, shefave të zyrave, nuk ka nevojë që të dërgohet diku tjetër për të bërë analiza se a duhet të na epet përgjigje apo jo ? Ka kaluar plotë një muaj që e kemi dorëzuar një kërkesë të cilën e ka hartuar Zyra e Personelit, por ajo ka mbetur te Zyra për Marrëdhënie me Publikun e cila merret me te dhe ka dilemë se a duhet dhënë përgjigje apo jo?

Duhet ta kuptojë secili drejtorë se ne nuk jemi publik, por jemi grup parlamentar dhe në çastin që kërkojmë ndonjë përgjigje ajo duhet të na epet neve.

Gjithashtu në emër të LDK-së kërkoj një informatë zyrtare nga kreu i Komunës dhe nga kryesuesi që në këtë rast të na epet një informatë lidhur me shkarkimin e drejtorit të DKRS-së , por të cilit iu është bërë një zëvendësim. Nuk është mirë që ne si Kuvend të mos jemi të njoftuar dhe të mos kemi njohuri se çka ka ndodhur në këtë drejtori?

Shefik Surdulli- mua më duhet ta jap një sqarim për anëtarët e Kuvendit se Zyra për Informim nuk ka të bëjë fare me qasje në dokumente publike, por është zyrtari i caktuar i cili kryen këtë përgjegjësi. Është Muhamet Pajaziti i cili jep përgjigje për qasje në dokumente publike. Çështja është te ky zyrtar dhe jo te Zyra për Informim.

Arben Mehmeti- e kam të qartë unë këtë, por kur bëhet fjalë për qasje të publikut në dokumente dhe e pranoj atë që e tha shefi i zyrës, por ne nuk kemi të bëjmë për qasje në dokumente zyrtare. Anëtarët e Kuvendit e kanë mekanizmin e tyre, sepse i kërkojnë informatat e drejtpërdrejta zyrtarëve, ne jemi grup parlamentar dhe nuk jemi qytetarë.

Ne këtë të drejtë e kemi edhe sipas statutit, por edhe në këtë Kuvend jemi marrë vesh që kështu të kthehen përgjigjet.

Shefik Surdulli- ligji për qasje në dokumente zyrtare i ka definuar këto gjëra saktësisht.

Sami Hoxha- është mirë të thuhet se nëse ndonjë shërbyes civil nuk i shërben ndonjë këshilltari Komunal, duhet të theksohet me emër. Nuk ka mundësi që këshilltarët komunal të shkojnë të presin në rend dhe të mos japin informatë zyrtarët e Komunës. Duhet theksuar me emër dhe nëse dikush e ka bërë një shkelje të tillë të dihet dhe të mos përgojohet Administrata Komunale dhe në tërësi Komuna.

Arben Mehmeti- lidhur me fjalën e z. Sami Hoxhës, po theksoj se unë kam bërë kërkesë zyrtare me emër dhe mbiemër në Zyrën e Personelit dhe përgjegjësitë të kësaj zyre, z. Besim Azizi. Unë kam kërkuar listën e stafit të Komunës në përgjithësi me të dhënat se secili kur ka hyrë në punë, sistematizimin e vendeve të punës, kontrata në vepër etj. Z. Besimi e ka kryer obligimin, por Zyra për Informim ka kërkuar që t' i dërgohet asaj, kurse Zyra për Informim ia dërgon dikujt tjetër (atij që e kërkon). Unë e sqarova me emër dhe mbiemër se ku e kemi kërkuar informatën, por edhe kush po e pengon për të dhënë këtë informatë.

Sami Hoxha- për mua nuk është bindës Arbeni, sepse ky është këshilltar komunal, shef i grupit dhe nuk ka nevojë të shkojë për t' i dhënë ata përgjigje dhe të presin, por ka qenë desh të shkojë në zyrë dhe të kërkojë atë dokument të cilin dëshiron. Në këtë mënyrë me siguri do ta kishte marrë informatën.

Tahir Arifi- mua m' u duk se u dha përgjigja në këtë rast dhe jo secili shërbyes ka të drejtë për të dhënë dokument kush do që kërkon. LDK-ja e di dhe gjithnjë kërkon që të respektohen procedurat dhe më duket se është obligim që të epet përgjigje, sepse kështu e ka përcaktuar ligji. Do të thotë është zyrtari i cili i jep përgjigjet dhe janë procedurat lidhur me dhënien e përgjigjeve.

Sadudin Berisha- mua më duket se po banalizohet një çështje e cila është e ditur. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me individët as me një qytetar të thjeshtë, por kemi të bëjmë me kërkesat e një të zgjedhuri nga qytetarët e kësaj Komune i cili i përfaqëson interesat e qytetarëve. Çdo kërkesë që adresohet në emër të anëtarit të KK-së, shërbimi përkatës do të duhej që detyrimisht t' i jep përgjigje në afatet e parapara ligjore. Kërkesat e grupit të këshilltarëve janë zyrtare dhe nuk kanë të bëjnë me kërkesat e qytetarit për qasje në dokumente publike e cila është një procedurë krejt tjetër nga ajo që ne kërkojmë këtu.

Izmi Zeka- është propozim-vendimi për propozim zgjidhjen urbanistike në lagjen “Dheu i Bardhë” dhe para se të kalojë në rend të punës kërkoj që të epet një arsyetim, nga zyrtari përkatës i Drejtorisë së Urbanizmit.

Fadil Sherifi- nevoja ka lind si detyrim i kërkesave të qytetarëve e cila kërkesë është e një kohe bukur të kaluar. Kemi kërkesë nga qytetari Kadrush Rexhepi i cili është deklaruar që në mënyrë vullnetare t' bëjë disa investime për një familje si rast social, por problemi ka qenë lokacioni. Ne kemi hapësirë komunale shumë pak, por aktualisht jemi në procesin e planit rregullues në lagjen “Dheu i Bardhë” gjegj se pjesë e Porodinit ku është një zonë mjaft e madhe. Në kuadër t' i këtij plani kemi ardhur deri te përcaktimi për një hapësirë e cila është pronë komunale, është në mes banimit individual e cila është propozuar sipas

kompanisë së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit dhe përveç kësaj familje ne kemi propozuar një hapësirë edhe për familje të tjera në sipërfaqe prej 15 ari që të shfrytëzohet për destinim të caktuar. Ne këtë e kemi diskutuar edhe në kuadër të Komitetit për Planifikim dhe përgjigjen në parim e kemi marrë dhe duhet të kuptohet se është vetëm një projekt- propozim i cili duhet t' i bashkëngjitet planit rregullues i cili është në proces dhe pas shqyrtimi të debatit publik dhe raportit përfundimtar të cilin e dorëzon kompania duhet të aprovohet.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të rendit të punës me propozimin që të hyjë edhe kjo pikë për propozim zgjidhje urbanistike në hapësirën publike; banimi Social”Dheu i Bardhë, por të jetë edhe një informatë nga vizita e zëvendës kryesuesit në Turqi. Gjithashtu të jetë edhe një informatë për shkarkimin e drejtorit të Kulturës.

Aprovohet rendi i punës me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 13 ishin kundër

Procesverbali

Në procesverbal nuk pati vërejte i cili u aprovua me një votë kundër, për shkak se procesverbali nga ana sekretarisë nuk është dorëzuar si kopje fizike, por vetëm në adresë elektronike.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2013-2015 e Komunës së Gjilanit,

Izmi Zeka- informatën më të plotë lidhur me këtë do të na e jep drejtori i financave.

Nuhi Nuhiu- sot kam rastin që para juve ta paraqes Kornizën afatmesme buxhetore të cilin material e keni marrë të gjithë dhe është një material që po e them se për herë të parë në Komunë të Gjilanit punohet në këtë formë korniza afta mesme buxhetore.

Ky është një material i cili në mënyrën më analitike është paraqitur ku i kemi të paraqitura të hyrat dhe shpenzimet në mënyrë të detajizuar. Ky buxhet ose ky dokument mund të bëhet përfundimtar, atëherë kur të aprovohet në Kuvend, do të thotë në seancën e shtatorit do të bëhet përfundimtar, sepse atëherë do të aprovohet buxheti i Komunës së Gjilanit.

Lidhur me këtë kornizë buxhetore ne shumë pak kemi ndryshime gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2013, 2014 dhe 2015, diku i kemi 300 mijë euro, diku 100 mijë etj.

Për këtë kohë Qeveria ka paraparë që ne si Komunë ta kemi buxhetin përafërsisht si vitet e tjera. Këtë vit përsëri e kemi një buxhet jo të mjaftueshëm i cili do të ketë mundësi që të na ndihmojë për kryerjen e obligimeve dhe nevojave që i kemi si Komunë. Mirëpo këta janë kufijtë të cilët përcaktohen edhe nga Komisioni i grandeve në nivelin qendror.

Sipas materialit që e keni buxheti i këtij viti është mbi 18 milion e 418 mijë euro.

Ky buxhet pastaj është i ndarë në kodet ekonomike si për mallra shërbime, për paga etj.

Për paga i kemi mbi 11 milion e 475 mijë euro ose llogaritur në përqindje i bie 63%.

Për mallra dhe shërbime i kemi 2 milion e 870 mijë euro ose 15.58%. Shpenzimet komunale 460 mijë ose 2.50%, subvencione dhe transfero kemi 571 mijë euro ose 3.10%, kurse investime kapitale janë 3 milion e 400 mijë euro, apo 16.50%.

Tendenca është që gjithherë të ketë rritje të investimeve kapitale, por për shkak se ende buxheti i Kosovës është i centralizuar, ende buxheti mbi 70% qeveritë komunale i marrin buxhetet prej grandit, kurse pjesën tjetër e kemi nga të hyrat vetanake.

Këtë vit edhe pse ne kemi insistuar që të hyrat vetanake të jenë 3 milion e 300 mijë euro, komisioni i grandeve dhe pas konsultimeve kemi ardhur në përfundim se buxheti i të hyrave vetanake i Komunës së Gjilanit të jetë 3 milion e 600 mijë euro.

Te të hyrat vetanake do të kemi problem për realizimin e tyre, sepse gjendja ekonomike është e rëndë dhe po vërehet se trendi i të hyrave vetanake ka rënie, por po shpresojmë se disa shtëpi shumë kate hyjnë në tarifën e tatimit në pronë i cili fakt do të na ndihmojë.

Sa i përket pagave kemi një buxhet social, një buxhet me të cilin më tepër mund t' i mbajmë punëtorët me të ardhura edhe pse ato të ardhura janë minimale.

Komuna e Gjilanit i ka 2441 punëtorë, kurse këtë numër nuk mund ta shtojmë kurrësi dhe këtë duhet ta respektojmë gjithsesi.

Gjithashtu edhe te mallrat dhe shërbimet i kemi 2 milion e 800 mijë euro, por tash janë rritur kërkesat për objektet e reja të cilat janë ndërtuar dhe aty duhen rojtare, mjete për pastrim dhe inventarë dhe këto gjëra na kanë detyruar që ta rrisim shumën e mjeteve për mallra dhe shërbime.

Shpenzime komunale i kemi 460 mijë euro e të cilat janë shpenzime të cilat i kemi planifikuar 90%, sepse i kemi përcjell rregullisht shpenzimet të cilat janë bërë gjatë viteve të kaluara. Mirëpo për këto shpenzime shkollat e reja dhe objektet e tjera mund të na krijojnë probleme, por më vonë me rishikim të buxhetit në muajin qershor apo në fund të vitit 2013 mund të bëjmë lëvizje prej një kategorie të shpenzimeve në kategorinë tjetër. Te pagat nuk do të ketë lëvizje dhe nuk mund të barten mjete prej një pozicioni në pozicionin tjetër.

Tek të hyrat e theksova se kemi rritje dhe te tatimi në pronë 1 milion e 208 mijë euro e kemi marrë kështu, sepse tash e kemi koeficientin 15%, kurse deri më tash ka qenë 8%. Tash është dyfishuar koeficienti dhe mendoj se do të arrihet planifikimi i vitit 2013.

Kjo ishte në pika të shkurtra, por kërkoj falje se në material po mungon planifikimi i të hyrave vetanake i cili është një lëshim i atij zyrtari i cili ka përgatitur këtë material.

Mirëpo e keni 3 milion e 600 mijë euro e cila shumë është e specifikuar nëpër drejtori.

Dhe këtë material është mirë ta keni edhe ju për të parë se si është planifikuar?

Pra në materialin e dërguar nga sekretaria nuk qëndron tabela e të hyrave vetanake.

Ju falënderoj për durim dhe e keni mundësinë për të dhënë komente, por edhe për të bërë pyetje.

Ziadin Maliqi- unë jam munduar për ta analizuar në ato mundësitë e mia këtë kornizë afatmesme buxhetore e cila kornizë së pari teknikisht është e përgatitur mjaft mirë.

Kjo është kornizë për tri vitet e ardhshme e cila është bazuar në qarkoren buxhetore sa i përket të hyrave do të thotë grandit dhe të hyrave vetanake. Ndërsa sa i përket shpërndarjes nëpër kategori të ndryshme është e ditur ato janë të përcaktuara nga zyrtarët e Komunës.

Kjo kornizë është për tri vitet e ardhshme, kurse në shtator do ta kemi buxhetin për 2013, por edhe për vitin 2014 dhe 2015 te projektet me pak ndryshime përshkrimi është i njëjtë.

Në këtë kornizë janë disa rreziqe siç i përmendi edhe drejtori, sepse grandet qeveritare mund të jenë edhe më të vogla, si është zvogëlimi i pjesëmarrjes nga 10 – në 8%.

Ne vërejtjet më të mëdha i kemi te shpërndarja nëpër kategori, sepse në kornizë thuhet se ky buxhet i ndihmon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por unë nuk shoh në bazë të këtij planifikimi që ka një zhvillim ekonomik me këtë buxhet.

Si gjithherë unë vërejtjet më të mëdha i kam te shpenzimet, sepse vërehet se shpenzimet për investime kapitale bien dukshëm prej vitit në vit dhe si shembull i tillë është prej 20% sa është në vitin 2012, bie në 16.5% në vitin 2013.

Mirëpo kemi rritje të madhe të shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilat për vitin 2013 do të jenë mbi 15% ashtu si është në kornizë, por sipas llogarive të mia del se këto shpenzime janë 18%. Në krahasim me vitin 2012 prej 12% të pjesëmarrjes, shpenzimet për mallra dhe shërbime në buxhetin e përgjithshëm në vitin 2013 rriten në 18% ose prej 2 milion e 120 mijë e 96 euro në vitin 2012, në 3 milion e 330 mijë 503 euro në vitin 2013 dhe nga kjo shihet se diku për 1 milion e 200 mijë euro rriten shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012. Për llogari të mia të kjo kategori e shpenzimeve është shumë e madhe, sepse ne kemi dhënë vërejtje edhe në vitet e mëparshme se shumë mjete po epen për mallra dhe shërbime, sepse ato ndikojnë në zvogëlim dhe shkojnë në dëm të investimeve kapitale.

Gjithashtu kemi rritje dhe të subvencionet të cilat i kam vërejt, e sidomos janë disa subvencione në bujqësi, mandej ka diçka edhe në shëndetësi me të cilin rast e vërejtja se thuhet se do të epen subvencione edhe për shërim jashtë vendit. Unë nuk kam asgjë kundër që të japim subvencione për shërim jashtë vendit, por ajo është në kompetencë të nivelit qendror, sepse Komuna nuk ka mundësi për subvencione të tilla dhe nuk mund të obligohet edhe me shpenzime të tilla.

Këto janë ato vërejtjet tona, sepse në bazë të kësaj kornize nesër planifikohet edhe buxheti, çka do të thotë prej kësaj në shtator do ta kemi edhe buxhetin.

Kjo është arsyeja që ne i japim këto vërejtje, sepse të kategoritë e ndryshme të shpenzimeve nuk janë për neve si grup i këshilltarëve të LDK-së, nuk janë në nivelin e duhur.

Te investimet kapitale nuk ka asgjë, as nuk ka investim në bujqësi, kurse shumë pak në infrastrukturë dhe këtu më tepër janë përfshirë kategoritë e mirëmbajtjeve si ndriçim publik dhe sinjalizime. Në infrastrukturë në ndërtimin e rrugëve të reja nuk ka asnjë projekt, sepse janë diku vetëm 3 qind mijë euro.

Ramiz Ramadani- në emër të grupit të LDK-së i tha të gjitha gjërat Zijadini, kurse unë shkurtimisht po i them disa gjëra në emër timin. Në prioritet strategjike zhvillimore të kësaj kornize bashkë me arsimin dhe bujqësia vendose në prioritet si të parat. Për këtë prioritet që iu është dhënë arsimit dhe bujqësisë mua më gëzoj, por në këtë sektor nëse bazohemi në të dhëna na del se nuk është ashtu!

Për shembull të subvencionet e kemi një rritje prej 160 mijë eurove e që thotë se 85% janë më të mëdha se vitin e kaluar dhe realisht është ashtu dhe kjo është një pasqyrë se sa kanë qenë subvencionet vitin e kaluar.

Mirëpo vërejtja e jonë është kryesisht të investimet kapitale të cilat investime në këtë kornizë buxhetore janë 60 mijë euro për projektet zhvillimore prej të cilave 56 mijë euro është projekti për drunjtë dekorativ dhe 4 mijë euro participim për projekte me donatorë.

Pasi që drunjtë dekorativ nuk kanë të bëjnë me zhvillim të bujqësisë, sepse kjo duhet të trajtohet nga sfera e ambientit ose hapësirave mjedisore dhe jo të kategorizohet në projekte kapitale në bujqësi. Nga kjo del se projekte kapitale për bujqësi në vitin 2013, 2014 dhe 2015 do të jenë 4 mijë euro dhe mendoj se drejtori i bujqësisë duhet të bëjë një ndryshim këtu. Vërejtje tjetër është se në atë planin që e kemi pasur për drunjtë dekorativ, parashihet që projekt në fund të vitit 2013 ky projekt të përfundojë, por unë e vërejtja se ky projekt do të vazhdojë deri në vitin 2015.

Një vërejtje tjetër e kam se në këtë kornizë buxhetore thuhet se: “vendimi i Asamblesë Komunale për lirimin e bizneseve të reja nga taksa komunale ka inkurajuar mbylljen e bizneseve.” Këtu thuhet edhe me shifër se 350 biznese janë mbyll si rezultat i këtij vendimi

dhe përsëri janë rihap të njëjtat. Mendoj se në çastin kur është konstatuar se të njëjtat biznese janë mbyll dhe përsëri po rihapen, ka qenë desh që mos t' i mundësohet kjo rihapje.

Këto biznese ka qenë desh të privohen nga kjo masë, kurse në të kundërtën është një keqpërdorim për të cilin dikush duhet të jap përgjegjësi.

Abdyl Aliu- unë shkurtimisht po them diçka për projektet kapitale të vitit 2013-2015 dhe më vjen keq, sepse edhe këto pak projektet që janë dhe këto pak mundësi që janë, nuk kanë pasur mundësi të vihen në prioritet dhe të gjejnë mundësi as më të voglën për lagjen “Zabeli i Sahit Agës”.

Edhe në këtë lagje ka nevojë për të gjitha këto projekte që janë përfshirë në pjesë të tjera të qytetit dhe nëpër fshatra. Ajo çka është edhe më e keqja deri në vitin 2015 kjo pjesë e qytetit do të jetë pa plan rregullues. Është e njohur se aty është një tendencë shumë e madhe e ndërtimeve dhe ndërtimet bëhen çdo ditë dhe është për keqardhje që deri në vitin 2015 në këtë pjesë të qytetit nuk do të ketë plan rregullues.

Bahrie Veseli – unë po mundohem të jap një kontribut në sferën e arsimit dhe po theksoj se në grand është përfshirë edhe çështja e arsimit. Mirëpo te planifikimi i projekteve për shkollë, është e ditur se të gjitha shkollat i kemi pa salla të edukatës fizike dhe përsëri është një mangësi e madhe se po shihet se përsëri nuk është planifikuar ndërtimi i ndonjë salle të edukatës fizike. Gjithashtu nuk është paraparë edhe ndërtimi i shkollës në lagjen “Arbëria” e cila lagje është e banuar me një numër të madh të banorëve. Për këtë arsyeje kërkoj që të përfshihet në prioritet edhe ndërtimi i një shkolle dhe ndërtimi i sallës së edukatës fizike i cili projekt duhet të bëhet dhe realizohet edhe për Zabelin dhe për Shkollën “Abaz Ajeti” e cila që nga themelimi është pa sallë të edukatës fizike.

Uroj që të realizohen premtimet e kryeministrit i cili ka deklaruar se të gjitha shkollat do të kenë kompjuterë i cili premtim nuk është realizuar deri më sot.

Arben Mehmeti- në takimin e KPF-së ka qenë edhe projekti për asfaltimin e rrugës Pogragjë-Llocë, por tash po vërehet se është heq nga prioriteti dhe nuk e di arsyen pse ka ndodhur kjo, por besoj se drejtori do të ketë përgjigje për këtë! Ne me këtë projekt e kemi rekomanduar në komitet për aprovim në Kuvend.

Po ashtu ka kërkuar që edhe rruga Llocë-Kokaj të trasohet dhe realisht të investohet në ato zonë kufitare ku kufizohet kufiri shqiptaro-shqiptar. Kjo pjesë është lënë anash, prandaj kërkoj që të jetë pjesë e projekteve për këtë periudhë deri më 2015. Këto projekte kanë qenë premtime edhe të kryetarit të Komunës gjatë debateve të mëparshme dhe është mirë që në këtë kornizë të përfshihen edhe këto projekte të planifikuara.

Arben Maliqi- sa i përket kësaj pike të rendit të punës ne e përshëndesim këtë kornizë afatmesme dhe i përshëndesim të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë planifikim dhe kjo është e para herë që në këtë planifikim kanë marrë pjesë edhe drejtorët të cilët i përshëndesim. Kjo është një punë e mirë, sepse ata janë këshilltarë të kryetari dhe i dinë gjërat dhe nevojat e qytetarëve më së miri.

Dihet se buxheti i Komunës sonë është i vogël, por ne jemi të anashkaluar, por kemi mundësi për të kryer shumë punë. Unë mendoj që së pari duhet t' i kryejmë punët të cilat i kemi filluar, pastaj edhe në KPF e kam thënë se duhet pasur në prioritet dy rrugë kryesore në

hyrje të Gjilanit dhe në dalje për Bujanoc të cilat rrugë mendoj se duhet të rregullohen në 4 korsi. Arsyeja është që qytetarët të kenë qasje të drejtpërdrejtë në hyrje të Gjilanit.

Mandej, unë mendoj që shumë çka u fol dhe nuk është mirë të përsëriten gjërat, mirëpo mendoj se është koha e fundit që gjithçka që punohet tash e tutje të punohet mirë, të kompletohet çdo projekt pa marrë parasysh a është shkollë, rrugë etj. Kërkoj që projekti të kryhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Konkretisht po i përmendi shkollat, mjaft kemi ndërtuar shkolla të mëdha, por jo shkolla të kompletuara dhe është koha që t' i kompletojmë këto shkolla me tërë infrastrukturën e nevojshme. Unë në emër të grupit e përshëndes këtë kornizë afatmesme buxhetore duke besuar se këto do të realizohen.

Shukrie Rapuca- unë po ndiej si obligim që propozimin e z. Abdyl Aliu për ta fuqizuar edhe më tepër, sepse rrallë ndodhë që të dakordohen interesat e pozitës dhe opozitës!

Në këtë Kuvend disa herë është përmendur Lagjja e Zabelit dhe ndoshta ka ardhur koha që kjo lagje të përmendet edhe për përrurime dhe jo vetëm për ankesa. Lagjja e Zabelit ka mbet ashtu sikur komunat e reja që janë formuar me decentralizim, prandaj duhet pasur parasysh edhe këtë lagjeje, sepse ndërtimet e egra jo vetëm që e kanë shkatërruar planet urbanistike të cilat kanë qenë, por vështirë do të jetë e dhe atëherë kur merr nismën për të bërë diçka lidhur me infrastrukturën do të jetë vështirë, sepse aty çdo gjë është në kaos.

Sokol Haziri- unë do ta paraqes mendimin e AAK-së lidhur me pikën e rendit të punës me vërejtjet e të gjithëve dhe me ato që i kemi konstatuar në KPF, që vërtetë ky është një buxhet jo i kornizave zhvillimore, por i vazhdimit të gjendjes së njëjtë.

Me vërejtjet parimore që i dëgjuam deri më tani AAK e mbështet këtë kornizë buxhetore.

Nevzad Rushiti- jemi në dijeni se disa projekte kanë mbetur në gjysmë dhe të papërfunduara e të cilat mendoj se ka qenë desh të përfshihen në këtë kornizë. Drejtoria e Urbanizmit në bazë të planit urbanistik e ka paraparë ndërtimin e një shkolle në Dheun e Bardhë afër Gllamës, por këtë projekt nuk e vërejtja në këtë kornizë buxhetore. Ky projekt ka qenë edhe në debat publik dhe është projektuar nga DUMM, por përsëri nuk është paraparë në këtë kornizë për këto tri vite të ardhshme.

Nuhi Nuhiu- unë po mundohem t' i jap disa përgjigje edhe pse e kam vështirë, sepse kërkesat janë të mëdha, nevojat e shumta. Ju e dini se çka është korniza, jemi brenda një rrethi. Zijadini e tha se korniza në aspektin teknik është në nivel, por po theksoj se edhe në atë përmbajtjesor është i mirë. Po bëhet pyetje pse të gjitha këto obligime të mallrat dhe shërbimet? Këto obligime po theksoj se janë rrit për shkak të shpenzimeve kapitale, apo investimeve kapitale. Nuk mund këto shpenzime për mallra dhe shërbime të jenë si më 2008. 2009 ose 2010, sepse ato investime kërkojnë mirëmbajtje.

Një pyetje ishte pse investimet kapitale janë më të vogla? Këto investime janë të tilla, sepse, pjesa dërmuese e mjeteve janë kategorizuar për mallra dhe shërbime.

Mirëpo 18% i buxhetit është për tri vite dhe jo për vitin 2013. Për vitin 2013 është 15.60%

Te çështja e subvencioneve, mos ta keqkuptojmë se subvencionet për shërim jashtë vendit nuk janë vetëm kompetencë e qeverisë, nuk ka kompetencë se i kujt është subvencioni.

Edhe Qeveria Komunale mund ndonjë rast ta dërgoj në shërim jashtë vendit.

U tha diçka për bujqësi nga Ramiz Ramadani, por ato janë mundësitë, janë të pakta, të mangëta, por kjo është fuqia e jonë.

Mirëpo nga të hyrat vetanake nëse inkasojmë mjete mbi planifikimin me rishikim ato mjete mund t' i shpërndajmë sipas nevojës dhe prioritetëve tona.

Është e vërtetë se ka mbyllje të bizneseve dhe hapje të bizneseve të reja, por është një e vërtetë se identifikimin në bëmë në terren është ai biznes i ri apo i vjetër. Nëse dikush tenton të kalojë prej biznesit të vjetër në biznes të ri, ne ia vazhdojmë atij taksat.

Drejtori dha edhe përgjigje të tjera lidhur me projektet.

Zijadin Maliqi- unë edhe thash fjalë të mira për këtë kornizë buxhetore dhe e tash se është e punuar mjaft mirë. Mirëpo parametrat buxhetor për shpenzimet, janë të mëdha dhe jo të llogaritura mirë. Nuk thash që nuk është mirë të japim subvencione për shëndetësi edhe për shërim jashtë vendit, por bëra pyetje a kemi mundësi ne si Komunë të bëjmë subvencionime të tilla? Kjo është shumë e mirë, por me këtë buxhet është vështirë të bëjmë diçka.

Mandej i dëgjova disa kërkesa për investime kapitale, sidomos për asfaltim të rrugëve në qytet dhe fshatra, por në bazë të kësaj kornize për 2013 nuk ka investime kapitale thuaja për asgjë, janë vetëm 330 mijë euro edhe ato për participim të projekteve me donatorë dhe si projekt i tillë po përmendet një shkollë në Kishnapol dhe disa projekte me Qeverinë dhe asnjë projekt tjetër nuk ekziston. Kjo ka ndodhur, sepse mjetet janë klasifikuar te mallrat dhe shërbimet. Tjetër u tha mirëmbajtja e investimeve kapitale, por nuk po e kam të qartë se për cila mirëmbajtje është fjala. Unë po e shoh për mirëmbajtjen e rrugëve janë ndarë mjete për investime kapitale, mjete të veçanta. Rrugë, trotuare, gjelbërime, janë diku afër 400 mijë euro. Te objektet është pozicion në veti: rekonstruimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore, pra këto janë te investime dhe jo te mallrat dhe shërbimet.

Duhet të keni kujdes, sepse mallrat dhe shërbimet janë shumë të mëdha dhe është mirë që në shtator një pjesë të këtyre mjeteve është mirë ta klasifikoni te investimet kapitale dhe të bëhet një buxhet për qytetarë dhe mos të jetë për pushtetarë. Nëse qytetarit i kthehet paraja që e jep vet, përmes investimeve kapitale i rregullohet një rrugë ose ujësjellës ai është buxhet për qytetarë.

Abdyl Aliu- unë i çmoj përpjekjet e drejtorit për të dhënë përgjigje për një çështje të cilën unë e shtrova, por do t' i them drejtorit se planifikimi ose Plan i rregullues në fakt është kushtetutë, si është kushtetuta për një shtet edhe Planifikimi është kushtetutë për aspektin e planifikimit të një komune. Unë desha ta them se qytetarët e “Zabelit të Sahit Agës” duhet të llogarisin se janë pa kushtetutë pa planifikim për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Sipas kësaj politike as viti 2015 nuk do të ketë planifikim për Zabelin! Plan i rregullues është përcaktim për zhvillim të atij vendi të asaj sipërfaqe ose atij territori. Në atë planifikim paraqiten nevojat e infrastrukturës së atij vendi si ujësjellësi, kanalizimi, gjelbërimi dhe për këtë arsyeje unë po e quaj planifikimin kushtetutë.

E falënderoj drejtorin për përpjekjet për të dhënë përgjigje, por kjo nuk është çështje e tij.

Izmi Zeka- duhet të dihet dhe po e kuptojmë se kjo është kornizë afatmesme, kurse në shtator do ta rishikojmë buxhetin e 2013 dhe ka mundësi që çdo vit për të bërë lëvizje të vogla, sepse buxheti bëhet për qytetarë.

Kjo është hera e parë që po e bëjmë një kornizë afatmesme buxhetore dhe gradualisht po fitojmë përvoja se si duhet të planifikojmë në vitet e ardhshme.

Bahrie Veseli- unë gjatë paraqitjes sime të parë nuk e përmenda dhe nuk e kam të qartë se në këtë kornizë a është përfshirë edhe rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të qytetit? Të gjithë e dinë se në çfarë gjendje i kemi varrezat dhe nuk e kam parë që është planifikuar ko çështje në këtë kornizë buxhetore afatmesme, duke përfshirë edhe rregullimin e varrezave të Dëshmorëve. Edhe ky projekt duhet të jetë i planifikuar, sepse është më se i nevojshëm për qytetarët.

Izmi Zeka – ju lus të deklarojeni kush është për aprovim të kësaj kornize afatmesme buxhetore për vitin 2013-2015

Aprovohet pika 2 e rendit të punës : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2013-2015 e Komunës së Gjilanit, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 12 ishin kundër

3. Propozim- vendimi për Zgjidhjen urbanistike të hapësirës publike: “Banimi social në Lagjen “Dheu i Bardhë”,

Izmi Zeka- përkitazi me këtë pikë informatën e morët dhe arsyetimin, por edhe më detalisht fjalën do ta ketë kryesuesja e Komitetit për Planifikim.

Florinë Zymberi- ky propozim për zgjidhjen urbanistike “Dheu i Bardhë” është për zgjidhje të çështjes së disa familjeve për banim social. Unë mendoj se për situatën e ekonomike e cila është në Komunë më shumë se kurrë kemi nevojë për objekte të karakterit social.

Nga ajo e cila ka arrit nga sekretaria dhe Drejtoria e Urbanizmit, ne kemi vërejt se prona është e Komunës dhe nuk paraqiten probleme pronësore.

Ka disa zëra që thonë se kjo nuk është pronë e Komunës, por drejtoria përkatëse e mban përgjegjësinë për t’ i vërtetuar këto gjëra, por nga ajo që unë e kam parë, kam vërejt se nuk kemi probleme pronësore dhe nuk bie në kundërshtim me planin zhvillimor urban.

Është me rëndësi që kjo të inkorporohet në Planin rregullues i cili është duke u hartuar në vazhdimësi. Ne duhet të pajtohemi që të kalojë kjo pikë e cila është me interes për qytetarët e sidomos për ata me gjendje të rëndës sociale.

Elisah Ymeri- ne nuk e kemi të qartë këtë rast se është fjala për banim social për shtëpi individuale, apo banim kolektiv? Të na epet një sqarim, sepse nuk është e jona vetëm ta ngrisim gishtin për pa pasur informacione të plota!

Nevzad Rushiti- unë po flas në bazë të informatave nga Komiteti për Urbanizëm, në të cilin komitet është anëtar i ynë Ramiz Ramadani. U tha edhe më herët se ky propozim nuk është debatuar në Komitetin për Pronë dhe nuk ka kaluar fare.

E dyta qëllimin që e pashë unë në këtë propozim nuk është me vend, sepse këtu nuk është fjala për ngritjen e një objekti social kolektiv, por aty janë 12 ari e të cilat duhet t’ i ndahen nga 2 ari për persona ose familje. Gjithashtu ai vend është tejet i vështirë, është një gurishte dhe është pjerrtësi derti në 40% dhe propozimin që e ka bërë urbanizmi apo kushdo qoftë unë nuk e kam pëlqyer. Ne jemi për t’ i ndihmuar skamnorëve, por në atë terren edhe donatori nuk do të kenë mundësi për të kryer punë. Unë mendoj se në atë vend i cili i ka 12

ari, duhet të analizohet mirë dhe të bëhet një objekt ose dy për banim social. Me çështje private dhe donacione nuk ka mundësi të bëhet asgjë aty!

Ne një rast kemi thënë kur është bërë një ndarje e tillë për një ish luftëtarë të UÇPMB-së kemi thënë që kjo të jetë hera e fundit dhe të kemi kujdes që ta ruajmë pronën publike, sepse në këtë formë nuk kemi bërë asnjë zgjidhje.

Sadudin Berisha- vazhdimisht është thënë dhe është rregull procedurale që pikat që propozohen siç është edhe ky rast i fundit nuk do të duhej fare të debatohen në Kuvend.

Shihet qartë se anëtarët e Kuvendit nuk kanë informacione të mjaftueshme dhe nuk mund të propozohet diçka për rend pune për diçka që nuk është përfillë procedura.

Së dyti anëtarët e komiteti nuk kanë informacione të mjaftueshme, kjo pikë ka qenë në Komitetin për Urbanizëm, por nuk ka qenë në Komitetin për Pronë e cila pikë ka të bëjë pikërisht me çështje pronësore.

Së treti nuk ka qenë fare në KPF, aty ku përcaktohet rendi i punës. Nuk është kjo një çështje e thjeshtë, të propozohet me procedura dhe pa procedura dhe të realizohet një qëllim i dikujt. Absolutisht grupi i këshilltarëve të LDK-së është që kjo pikë të mos debatohet dhe të përgatitet proceduralisht dhe pastaj të vije në Kuvend.

Elisah Ymeri- ne kemi pasur një çështje të tillë dhe ia kemi ndarë një troll komandantit, të UÇPMB-së dhe atëherë e kam pas dhënë një propozim që të bëhet një zgjidhje për të gjithë edhe për skamnorët, veteranët dhe për të gjithë ata që e meritojnë. Në këtë formë si jemi duke shkuar ne kemi dhënë plotë troje dhe të pavlera.

Unë personalisht nuk jam i përgatitur për ta ngrit gishtin, sepse nuk e kam të qartë pse?

Sokol Haziri- këtu është një dilemë dhe ne do të mund të bënim shmangie nga rregullorja e punës për hir të ndonjë rasti social, por megjithatë po e them me keqardhje se nëse një i varfër pasi ka mund të jetojë deri në këtë muaj, ai do të mund të mbijetojë, kushtimisht po e them edhe një muaj. Këtë rast duhet analizuar mirë të zbatohen procedurat dhe unë jam ihtar i asaj që të ngriten objekte kolektive për banim social se sa të parcializohen rastet e tilla, sepse pos një shtëpie, aty nevojiten edhe investime të tjera. Në këtë vend mungesa infrastrukturës është e mangët dhe do të ishte mirë që kjo çështje të shtyhet dhe të gjejmë alternativa të tjera dhe ne nuk po e dimë rastin saktë se kush është ky person. Mandej nuk e di a ka ndonjë komision të veçantë që merret me këto çështje dhe i trajton kërkesat.

Izmi Zeka- ne e marrim përgjegjësinë mund ta shtyjmë, por donatori është duke pritur për ta ndihmuar një skamnor. Mjetet janë, ka dashur dikush t'ndihmojë një skamnori i cili po e pret vetëm një vendim tonin të KK-së.

Florinë Zymberi- në këtë lokacion që po e propozojmë, kush është profesionistë i kësaj lëmie e vëren se nuk ka mundësi të ngriten objekte me shumë kate, sepse është një lokacion shumë i ngushtë dhe nuk i plotëson normativat e ndërtimit.

Unë personalisht nuk do të isha pajtuar për një objekt të lartë në një lokacion kaq të ngushtë dhe me dimensione aq të vogla.

Sami Hoxha- unë mendoj se ne shumë herë kemi marrë vendime si KK që kanë qenë në interes të qytetarëve, por edhe si raste të veçanta. Unë nuk mund të votoj sot për një rast për

të cilin nuk e di se kush është? Nuk mund të votoj sot për një rast që ndoshta nesër mund të turpërohem për pa e ditur se kush është ajo familje skamnore?

Ka qenë desh të precizohet dhe të thuhet saktësisht për ke është fjala dhe unë nuk jam për të bërë gjëja një zgjidhje për pa e ditur se për ke po bëjmë këtë zgjidhje?

Donatorë janë gjet shumë herë për raste sociale që kanë ardh nga malësia për ta sjell në qytet dike, por ato nuk janë arsyeje, duhet të jenë arsyet shumë të argumentuara dhe të qëndrueshme.

Ne kemi marrë një vendim herën e kaluar, por e kemi ndërgjegjen e pastër, sepse ia kemi bërë një zgjidhje një njeriu që ka dhënë një kontribut të çmueshëm dhe e kemi arsyetuar të gjithë. Nuk mund të votojmë për pa e ditur se për ke po votojmë.?

Fadil Sherifi- te banimi social ku e keni sipërfaqen është banim kolektiv, banim kolektiv ka procedura, banim kolektiv ka periudha të caktuara kohore të cilat nuk mund t' i realizojmë.

Duhet ta dimë si qytetarë dhe unë si profesionist në DUMM, se në kuadër të planeve rregulluese edhe sipas ligjit 25% të sipërfaqeve për banim social qofshin edhe hapësirat të cilat edhe janë private. Rasti konkret është hapësirë komunale dhe sipas Planit rregullues të Poredinit është hapësirë e dedikuar për gjelbërim. Është një zonë mbi një hektar dhe DUMM nuk merret me pronarë, por kemi vetëm një kërkesë nga Kadrush Rexhepi i cili dëshiron për të investuar.

Mimozë Kadriu- unë kam qenë anëtare këtij komisioni më herët dhe e di gjendjen si është dhe po them se fatmirësisht çdo nismë e tillë është e mirëseardhur, sepse e di gjendje shumë mirë gjendjen si është dhe sa ka kërkesa. Mirëpo kjo formë e zgjidhjes nuk po më pëlqen, sepse donatorët duhet të kenë mirëkuptim dhe duhet të kalojnë disa procedura. Është mirë të presin edhe pak, sepse ne nuk mund të bëjmë një zgjidhje ad-hok. Duhet të epet arsyeja kush janë ata pronarë, donatorë dhe përfitues, duhet ta dimë gjendjen mirë.

Unë edhe kur kam qenë anëtare këtij komisioni nuk kam qenë për banim social, sepse kriteret për pranimin e atyre familjeve janë të gjëra dhe të komplikuara sa që përfshijnë edhe banorët e Luginës së Preshevës të cilët vijnë në Gjilan dhe përfitojnë ndihma dhe banesa në mënyrë të pamërituar.

Sadri Arifi- është vërtetë që ky propozim-vendim nuk ka kaluar në KPF dhe ka ardhur si propozim pas afatit ligjor. Këtu është fjala për një vendim i cili ka të bëjë me zgjidhje të hapësirës urbanistike e cila do të jetë pjesë e planit rregullues urban. Në këtë fazë nuk ka nevojë të kalojë në Komitetin për Pronë, por kjo do të bëhet më vonë.

Sot është fjala vetëm për hapje të rrugës për zgjidhje urbanistike, kurse rastet sociale do të shqyrtohen më vonë.

Izmi Zeka- këtu ka zgjidhje urbanistike, jo dedikim, jo emri dhe mbiemri dhe pasi po kërkon për ta shtyrë unë po propozoj që ta shtyjmë.

Sadudin Berisha- këtu është një kërkesë e cila është e qartë, por në tërë debatin është paragjykuar zgjidhja përfundimtare si do të jetë! Është paragjykuar paraprakisht se si do të jenë përfundimi i këtij projekti.

Së dyti ky Kuvend duhet të nxjerr vendim për një parcelë e cila është pronë e saj dhe të ketë dedikim të qartë. Nuk është ai vendim për atë hapësirë dhe pastaj duhet kaluar një

sërë procedurash për të arrit deri te qëllimi i fundit. Asgjë deri më tash nuk ka ndodhur këtu dhe kjo nuk i përngjan studimit dhe punës të një drejtorie profesionale dhe veçmas është e gabuar qasja politike që ju e bëni në KK.

Tahir Arifi- unë mendoj pas fjalës së shefit të Shërbimit të Kuvendit, z. Sadri Arifi u sqarua çdo gjë dhe unë nuk jam rob i procedurave dhe si po duket se ata që mund të jenë përfitues potencial nuk e njohin askënd prej neve dhe për këtë kjo po zvarritet.

Fadil Sherifi- Drejtoria Urbanizmit, Sektori i Planifikimit i cili është përgjegjës për planet rregulluese ka dal në vend të ngjarjes e ka verifikuar hapësirën e cila është, por edhe kompania e cila është hartuese e projektit edhe ajo ka qenë në vend të ngjarjes dhe ky është projekt - propozim i cili është në fazën e shqyrtimit publik. Kjo fazë e debatit publik përfundon edhe dy ditë për këtë plan rregullues. Ky plan rregullues duhet të aprovohet në KK- dhe pastaj nuk kemi mundësi që këtë tokë e cila është e dedikuar si zonë për gjelbërim për ta kthyer në banim individual.

Elisah Ymeri – unë e kundërshtoj parafolësin Tahir Arifi, sepse ju e dini mirë që unë herën e kaluar e kam njohur mirë atë zotërinë të cilit ia kemi dhënë tokën dhe kam qenë kundër dhe jam kundër ndarjes së këtyre tokave. Megjithatë si plan rregullues është shumë e qartë, sepse nuk u tha asnjëherë dhe me fjalinë e fundit u kuptua se ne do të dalim me propozim vetëm për ndryshim të planit rregullues. Kështu është e pranueshme, kurse sa i përket çështjes që ne e njohim apo jo dike, unë personalisht e ngris gishtin i vetëdijshëm dhe nuk votoj me subjektivizëm.

Florinë Zymberi- në Komitetin e Urbanizmit nuk na ka ardhur asnjë njeri me emër dhe mbiemër se kush do të jetë përfitues, kjo duhet të jetë e qartë!

Arben Mehmeti- unë mendoj se u qartësua kjo dhe nuk pajtohem me Tahirin se nuk paska njohur askënd këtu! Pikërisht është e kundërta se e paska njohur dike shumë mirë dhe jashtë procedurave ligjore është sjell në Kuvend dhe ne nuk e votojmë. Edhe nëse merret vendim ne mund të bëjmë telashe ligjore në të ardhmen dhe mund të themi se nuk janë zbatuar procedurat, nuk kanë kaluar afatet ligjore etj. Kjo veç si kërkesë nuk i ka plotësuar afatet ligjore, përndryshe edhe unë mund ta siguroj një donacion për ndonjë rast e që njoh shumë raste të tilla, mund ta sjell një kërkesë në seancën e radhës dhe pastaj t'ia ndajmë një lokacion. Ne si grup dhe personalisht nuk jemi kundër zgjidhjes së problemeve dhe për zgjidhje të problemeve sociale jemi dhe kemi qenë vazhdimisht, por jo në këtë formë dhe në mënyrë të paligjshme, duke menduar se po i ndihmojmë po i shkelim ligjet dhe rregulloret në fuqi me arsyetim se po i ndihmojmë dikujt.

Ajo çka thuhet edhe dy ditë e diçka tjetër, konsideroj se këto janë kërcënime për këtë Kuvend dhe nuk do të biem në grack prej drejtorive, por as prej kryesuesit.

Kryesuesi në të shumtën e rasteve ka kërkuar të zbatohen procedurat dhe ka qenë për respektim të procedurave, kurse tash po del se po shërben me masa kërcënuese për t'ia realizuar dikujt një kërkesë. Duhet kuptuar se secili prej neve ka mundësi për ta gjet një rast për ta gjet një donacion dhe pastaj t'ia sjellim një kërkesë këtu dhe atëherë del ajo Tahirin se dikush ka të njohur këtu dhe duhet siguruar një lokacion.

Në këtë formë si po veprojmë, këtu mund ta bëjmë lagje sociale e cila gjë është e papranueshme, sepse duhet menduar për një objekt kolektiv aty.

Unë kërkoj që edhe ky rast të kthehet prapa dhe të respektohen procedurat, por DUMM jo të planifikojë aty diçka për të bërë lagje sociale.

Izmi Zeka- është keqkuptuar, këtu është një zgjidhje urbanistike një ndryshim dhe kjo është e qartë dhe mos të paragjykojmë tash se kush do të jetë përfitues. Ne po paragjykojmë, por fajtorë janë edhe kryesuesja e Komitetit për Planifikim dhe shefi i Sektorit për Planifikim, sepse nuk u dhanë sqarime të qarta..

Kush është për aprovim të këtij propozim-vendimi?

Nuk aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim- vendimi për Zgjidhjen urbanistike të hapësirës publike: “Banimi social në Lagjen “Dheu i Bardhë”, sepse 13 anëtarë të Kuvendit ishin për, kurse 16 ishin kundër.

Të ndryshme

4. Informatë nga vizita e zv/kryesuesit të Kuvendit në Turqi

Izmi Zeka-zv/kryesuesi me një ekip ka qenë në një vizitë në Turqi, për të cilën vizitë do të na jep informatë më të hollësishme.

Selim Selimi- së pari iu përcjelli përshëndetjet nga Komuna së binjakëzuar e Jelldërmit, me rastin e vizitës që e patëm më 21. 6. 2012 deri më 25.6.2012. Dihet se Bursa është një kryeqytet i parë i Perandorisë Osmane e cila i ka 17 komuna që e përbëjnë bashkësinë dhe njëra prej tyre është edhe Jelldërmi. Bursa ka gjithsej 2 milion e 700 mijë banorë si bashki, kurse komuna me të cilën jem të binjakëzuar i ka 700 mijë banorë.

Kjo komunë është e binjakëzuar me 17 komuna vendore dhe jashtë vendit. Kjo komunë është shumë e pasur me trashëgimi kulturore e të cilat janë restauruar si qendra kulturore dhe me objekte dhe qendra kulturore të moderuara.

Nga trashëgimia kulturore është edhe një fshat në periferi të saj i vjetër 700 vjeçar i cili fshat është në mbrojtje të UNESK-os. Në këtë fshat patëm rastin ta përcjellim një festival i cili mbahet 15 vjet me radhë dhe quhet “Festivali i Malinave”. Gjithashtu ky është një qytet i cili e ka të zhvilluar industrinë e tekstilit, por posedon edhe me fabrikën e automjeteve. Vizita e delegacionit tonë ishte e paraqitur edhe në media të shkruara dhe elektronike. Ky qytet gjithashtu ka edhe një sheh i cili quhet “Sheshi i Flamujve” në të cilin shesh është edhe Flamuri i Kosovës dhe emblema e Gjilanit e cila është shenjë e qytetit të binjakëzuar. Qyteti i Bursës ka një numër të madh të banorëve me prejardhje shqiptare i cili komunitet ka një privilegj dhe përfaqësohen edhe në komunë dhe në biznes.

Ne si delegacion u takuam me kryetarin e Komunës, i bëmë vizitë të gjitha drejtorive dhe zyrave përkatëse të drejtorive. Ishte një vizitë për kënaqësi dhe me vlerë dhe besoj se tërë delegacioni nga kjo vizitë ka bindje të mira.

Tahir Arifi- unë e shfrytëzoj rastin për të falënderuar kryesuesin e Kuvendit për mbështetjen që i ia ka bërë këtij udhëtimi të Komitetit për Kulturë së bashku me disa këshilltarë të tjerë komunal. Vizita ka qenë e frytshme dhe shumë me vend dhe shfrytëzoj rastin për ta falënderuar drejtorin për aranzhimin e kësaj vizite dhe e falënderoj për

bashkëpunimin që e ka pasur me Komitetin e Kulturës, por ishte për kënaqësi edhe kolegjaliteti që ne e kemi pasur dhe uroj që edhe herëve të tjera të kemi këso vizita.

Shukrie Rapuca- unë i kam disa pyetje; kush ka marrë vendim të bëhet kjo vizitë? Kush ka vendos? Çfarë përbërje ka qenë? Me çfarë kriteri është bërë kjo vizitë?

Unë kam dëgjuar se aty ka pasur vetëm anëtarë të atij komiteti, por ka pas edhe anëtarë tjerë të cilët fare nuk kanë qenë të inkuadruara në rrjedhat institucionale dhe kështu me radhë.

Unë kam paqartësi dhe kam pakënaqësi për këtë vizitë!

Bahrie Veseli – e kuptuam kjo ishte një informatë e shkurtër për vizitën, por dëshiroj për ta ditur se cili ka qenë qëllimi i kësaj vizite? Si qëllim ka qenë vetëm vizita, apo ka pasur ndonjë përfitim nga kjo vizitë. Nëse ka pasur ndonjë përfitim cili ka qenë ai?

Izmi Zeka- unë nuk e kam në plan që ta pyes dike se kush do të shkoj në vizitë jashtë apo brenda vendit.! Dhe nuk ka nevojë zv/kryesuesi të arsyetohet para këshilltarëve komunal.

Me këtë seanca përfundoi, kurse kryesuesi të gjithë anëtarëve të Kuvendit iu uron pushim të rehatshëm dhe fillim të mbarë të punës në shtator.

Seanca i përfundoi punimet në ora 11.40 min.
Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA